



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË



PRANUAR MË: 30.09.2014
ACCEPTED ON:
PRILJENO:
Nr.No.Br. 02 / 354



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna e Malishevë / Municipality- Malisheve

RREGULLORE PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME

(Për vitin 2015)

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 03/L-204** të datës 7 tetor 2010 të Parlamentit të Kosovës, dhe Ligjit Nr. 03L/0-40 për vetëqeverisje lokale, Statutit të Kuvendit Komunal të Malishevës, Asambleja Komunale në mbledhjen e vet të mbajtur me datë:26/09/2014, aprovon këtë:

RREGULLORE MBI TATIMIN NË PRONË

Neni. 1.

1. Duke u bazuar në Nenin 6 të **Ligjit Nr. 03/L-204 mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme**, baza tatimore do të caktohet si më poshtë:

Sipas Zonave në bazë të vlerës së tregut në m²

Destinimi i objektit	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV
Prona rezidenciale-shtëpi	255€	213€	170€	145€
Prona rezidenciale-banesë	298€	255€	213€	170€
Prona industriale	213€	187€	170€	170€
Prona komerciale	467€	298€	238€	170€
Prona bujqësore	153€	128€	128€	128€
Pronat e braktisura	100€	70€	50€	40€
Fushat sportive dhe pishina	100€	80€	60€	40€

Neni 2.

1. Duke u bazuar në udhëzimin administrativ nr.3/2011, nenin 5 dhe pikën 1.8.1, do të llogaritet edhe koeficienti i kualitetit (gjendejes) të ndërtesës.

Neni 3.

1. Duke u bazuar në vend ndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj në Komunën e Malishevës janë përcaktuar katër zona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë.

Neni 4.

1.1 Zona e parë përfshin të gjitha banesat, shtëpi dhe lokale afariste që gjenden përkaj rrugës “Adem Jashari” , Skënder Beu”, “Imer Krasniqi” dhe “Rilindja Kombëtare” në largësi deri në 200 m nga rrugët kryesore në Malisheve.

1.2 Zona e dytë përfshin të gjithë shtëpitë dhe objektet afariste të cilat janë në brendi të qytetit. Në largësi prej 200 metra jashtë zonës së parë. Si dhe zonën urbane në Banjë dhe zonën urbane në Kijevë.

1.3 Zona e tretë përfshinë fshatrat: Balincë, Tërpeze e Ulet, Carrallukë, Drenoc, Kijeve- zona jo urbane, Bubavec, Lubizhde, Mirushe, Dragobil, Astrazup, Maxharre, Bellanice, Banje, Mleqan Llazice dhe Temeqinë.

1.4. Zona e katërt përfshin fshatrat rurale të Komunës së Malishevës: Guncat, Bardh, Senik, Lladroc, Tërpeze, Berishe, Kervasari, Guriq, Pagarushe, Shkoze, Marali,

Burim, Gurbardh, Pllaqice, Vërmicë, Golluboc, Damanek, Bubel, Janqisht, Turjake, Panore, Llapqeve dhe Shkarashnik

Neni 5.

1. Në pajtim me neni 7 të **Ligjit Nr. 04/L-100 mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme**, normat tatimore të tatimit në prone për vitin tatimor 2015 për Komunën e Malishevës janë siç vijon:

Nr	Lloji i pronës	Norma e tatimit
1.	Prona rezidenciale-shtëpi	0.15%
2.	Prona rezidenciale-banesë	0.15%
3.	Prona industriale	0.15%
4.	Prona komerciale	0.15%
5.	Prona bujqësore	0.15%
6.	Pronate braktisura	0.15%

Neni 6.

1. Pronat të cilat lirohen nga tatimi në prone e të cilat janë të cekura në nenin 8 të **Ligjit Nr. 03/L-204 mbi Tatimin në Pronën e paluajtshme**, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Malishevës

Neni 7.

1. Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veçanta mund të bëhet konform nenit 16 të **Ligjit Nr. 03/L-204 mbi Tatimin në Pronën e paluajtshme**.

Neni 8.

1. Në pajtim me nenin 22 të **Ligjit Nr. 03/L-204 mbi tatimin në Pronën e paluajtshme** mbi përgjegjësitë komunale, Kryetari i Komunës së Malishevës emëron Bordin e Pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve për vitin 2015 .

Neni 9.

1. **Ligji Nr. 03/L-204** i datës 7 tetor 2010 dhe udhëzimet administrative rregullojnë të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronë e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

Neni 10.

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Asamblesë komunale dhe e njëjta do të zbatohet për vitin 2015.

Më: 26/09/2014

Malishevë

Kryesuesi i Asamblesë Komunale

